



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 5.12.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Driton Çaushi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj – Halimaj.

**Munguan:** Abdyl Salihu, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Nezir Cocaj.

**Përfaqësues tjerë:** përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Shaip Goxhuli dhe Lule Ymeri.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;**
- 5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.11.2018**

Procesverbali i mbledhjes së datës 26.11.2018, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport**

**Ismajl Kurteshi**, tha se komisioni ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/24 për Sport dhe ka miratuar raportin me 3 (tri) amendamente, të cilin e procedoi për komisionet e përhershme, më 15.11.2018, për shqyrtim dhe vlerësim. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar raportin me rekomandime për këtë projektligji dhe kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, 4 (katër) për dhe 2 (dy) kundër, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24, Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport, ta procedojë për lexim të dytë.

### **4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit**

**Ismajl Kurteshi**, tha se komisioni ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe ka miratuar raportin me 1 (një) amendament, të cilin më datë 15.11.2018 e ka proceduar te komisionet e përhershme, për shqyrtim dhe vlerësim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar raportin me rekomandime për këtë projektligji dhe kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, amendamentet e propozuara

nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, katër për, një kundër dhe një abstenim, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ta procedojë për lexim të dytë.

#### **5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive**

**Ismajl Kurteshi**, lidhur me këtë projektligj, tha se komisioni ka përfunduar me shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive dhe ka miratuar raportin me 2 (dy) amendamente, të cilin e procedoi për në komisionet e përhershme, më 15.11.2018, për shqyrtim dhe vlerësim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian, kanë shqyrtuar Raportin me rekomandime për këtë projektligj kanë konstatuar se amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë dhe nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni, me shumicë votash, katër për, dhe dy kundër, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, ta procedojë për lexim të dytë.

#### **6. Të ndryshme**

**Driton Çausi**, foli për OJQ-në “Zëri i komuniteteve” dhe formimin e një grupi lobues nga grupet parlamentare, që ka të bëjë me avokimin për të drejtat e tyre dhe alokimin e mjeteve buxhetore në vlerë prej 500.000 (pesëqindmijë) euro për financimin e mësimit plotësues për këtë qendër.

**Ismajl Kurteshi**, tha se ditë më parë e ka vizituar një qendër të tillë në Fushë-Kosovë dhe është njoftuar edhe me aktivitetet e tyre, që ishin të shumta dhe sfidat me të cilat ballafaqohen.

**Teuta Haxhiu**, tha se në Gjakovë ekzistojnë dy qendra të tilla, të cilat i ka vizituar dhe është njoftuar për së afërmi me aktivitetet që realizohen aty. Më tej, theksoi se sfida mbetet përgatitja e stafit në këto qendra dhe pajtohet me atë se të njëjtat duhet ndihmuar financiarisht.

**Valentina Bunjaku- Rexhapi**, tha se pajtohet me propozimin për mbështetje financiare për këto qendra, pavarësisht çfarë ka bërë MASHT për këtë qendra.

**Albulena Balaj- Halimaj**, kërkoi që fillimisht të marrim informacione nga MASHT, lidhur me atë se cilat OJQ i ka mbështetur dhe si i ka mbështetur ato.

Komisioni, pas përfundimit të mbledhjes, zhvilloi një takim me përfaqësues të GIZ-it, ku u prezantua analiza e përgatitur nga GIZ, lidhur me koherencën e legjislacionit primar me legjislacionin sekondar në fushën e arsimit parauniversitar.

Anëtarët e komisionit vlerësuan lart analizën, e cila ka për qëllim identifikimin e mospërputhjes së akteve nënligjore në raport me legjislacionin, si dhe të gjeturat dhe rekomandimet e dala nga analiza.

Komisioni falënderoi përfaqësuesit e GIZ-it për mbështetjen dhe përkrahjen në ngritjen e kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor, si dhe gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

***E përgatiti:***  
***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetari i komisionit,**

-----  
**Ismajl Kurteshi**